

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TAKIMIN ONLINE PËR KËSHILLAT VENDORË TË SIGURISË PUBLIKE

4 mars 2021

E nderuar znj. zëvendësministre Kuko, të nderuar Kryetarë, të nderuar pjesëmarrës!

Jam shumë i kënaqur që marr pjesë në hapjen e kësaj tryeze online kushtuar një teme e cila duket se ka marrë edhe më shumë rëndësi në këto kohë të vështira që po përjetojmë të gjithë për shkak të pandemisë. Sot do të kemi në fokus gjashtë Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike të mbështetur nga Prezenca, si dhe Raportin e Vlerësimit të funksionimit të tyre.

Patjetër që kohë të tilla na kujtojnë se sa e rëndësishme është të kemi platforma funksionale për ndarjen e shqetësimeve dhe për ndërmarrjen e veprimeve kolektive për të trajtuar sfidat që prekin komunitetet në nivelin bazë të vendit, aty ku ndodh jeta e përditshme, ku problemet janë të prekshme dhe ku zgjidhjet e punës mund të hedhin themele të forta për një shoqëri të shëndetshme. Besoj se të gjithë jemi dakord që në të gjitha kohërat, por sidomos në kohë sfiduese, platformat e bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve që mund të kontribuojnë në lehtësimin e situatave problematike janë ato për të cilat kemi më shumë nevojë.

Unë do të doja të krenohesha me faktin që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ishte organizata që ka mbështetur, që nga viti 2016, krijimin e Këshillave të parë Vendorë të Sigurisë Publike. Gjithashtu, dua të shpreh kënaqësinë që një përvojë e tillë e suksesshme pati një reagim të shpejtë dhe pozitiv nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe, sigurisht, nga Ministria e Brendshme, me nxjerrjen e një Udhëzimi për Bashkitë në lidhje me përbërjen dhe funksionimin e kësaj strukture të re. Procesi i krijimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike filloi në bashkitë Elbasan, Librazhd dhe Cërrik, me të cilat Prezenca në Shqipëri punoi ngushtë për ngritjen e strukturave përkatëse. Sot, ne ecim drejt një rruge të sigurt për krijimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike në të 61 bashkitë e Shqipërisë. Në këndvështrimin tim pozitiv, kjo tregon se ka pritshmëri që Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike mund të luajnë një rol të rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës së komuniteteve vendore.

Në shumë mënyra të ndryshme, qasja e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike qëndron në zemër të angazhimeve të OSBE-së, pasi përfshin një gamë të gjerë vlerash që Organizata ime i mbështet fuqimisht dhe promovon vazhdimisht për të gjitha shtetet pjesëmarrëse: gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin. Përmes kësaj, unë do të doja të theksoja se Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike janë më shumë se forume të sigurisë. Në thelb, ato janë platforma që funksionojnë përmes një procesi demokratik të gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes, proces i cili është hapur për kontribut nga të gjithë aktorët që përbëjnë komunitetet vendore - nga administratorët vendorë të zbatuesit e ligjit, nga institucionet e kujdesit shëndetësor publik të shoqëria civile, të rinjtë dhe udhëheqësit fetarë. Prandaj, është një forum dhe një proces që mbart një potencial të madh për të siguruar një jetë më të sigurt në komunitet, duke ndërtuar në të njëjtën kohë ura midis të gjithë

aktorëve vendorë, të cilët kanë një rol për të luajtur në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve vendore dhe rritjen e demokracisë në nivel vendor.

Sidoqoftë, sukcesi i krijimit të strukturave kaq të rëndësishme në të gjithë Shqipërinë ka të metat e veta, duke qenë se ato ende nuk janë plotësisht funksionale. Pas pak, do t'ju paraqitet Raporti i Vlerësimit për funksionimin e KVSP-ve, i cili është përgatitur me mbështetjen e Prezencës. Më lejoni të përmend një pjesë të përfundimeve të rëndësishme që sjell ky raport, të cilat na tërheqin vëmendjen të gjithëve për çështjet që duhen trajtuar. Kështu, raporti ka arritur në përfundimin se “këto struktura të reja përballen me një sërë sfidash, në mesin e një mjedisi ligjor dhe strategjik në zhvillim. Këshillat duhet të rregullojnë më tej punën e tyre dhe të garantojnë nivelin më të lartë të mundshëm të pjesëmarrjes nga të gjithë palët e interesuara”. Më duket veçanërisht e rëndësishme në raport pjesa ku pohohet se “ky proces shkon krah për krah me njohuritë e anëtarëve për rolin dhe bashkërendimin e tyre në përgjigje të menaxhimit të krizave, katastrofave natyrore dhe sfidave të tjera të sigurisë publike. Nga ana tjetër, ndërsa është e vërtetë që të gjitha komunat e synuara kanë miratuar Planet e Veprimit, ata duhet të zhvillojnë mënyra dhe mjete për t'i zbatuar dhe monitoruar ato, me tregues të qartë të ndikimit”.

Kam besim që diskutimet që do të pasojnë, duke u bazuar edhe në Raportin e Vlerësimit, do të sjellin si rezultat një vijim të frytshëm të punës për përmirësimin e mjedisit të nevojshëm për funksionimin e këtyre strukturave, sado të reja qofshin ato. Do të doja të përfitoja nga ky rast për të konfirmuar gjithashtu gatishmërinë e Prezencës për të vazhduar mbështetjen ndaj këtij procesi, duke ofruar ndihmën e saj në nivelin qendror dhe vendor për të trajtuar ndonjë mangësi teknike.

Besoj se një projekt i tillë mund të konsiderohet pa rezerva si një projekt me potenciale të mëdha i cili, sikurse e thotë edhe emri i tij, jo vetëm mund të përmirësojë situatën e sigurisë së komuniteteve vendore në Shqipëri, por gjithashtu mund të sjellë një kulturë të fortë të komunitetit dhe të bashkëpunimit midis komuniteteve dhe palëve të interesit për të adresuar një sërë sfidash të sigurisë në terren, gjë e cila është mjaft e rëndësishme. Prandaj, Prezenca do të vijojë të jetë partnere kryesore në këtë përpjekje.